



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 74 prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 14 / 05 / 2025

VENDIM

Nr. 16 date 14 / 05 / 2025

PËR

PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT

“Rehabilitim i digës së Tplan, Bashkia Tropojë”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 14.05.2025 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e paraqitur nga Bashkia Tropoje për Rehabilitimin e digës së Tplan në bashkinë Tropoje.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente “DERBI-E” dhe e dorëzuar në SKDM nga bashkia Tropoje. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se projekti nuk ka plotësuar kërkesat e legjislacionit përkatës. Në këtë dokumentacion mungojnë studimi dhe Raporti gjeologjik dhe sizmik, llogaritjet e qëndrueshmërisë së digës, mungojnë raporti për instrumentat e monitorimit të digës si dhe nuk janë parashikuar asnjë prej sistemeve të monitorimit të kërkuara në VKM e mesiperme. Gjithashtu, projekti nuk është i shoqëruar nga një raport i firmosur nga një studio keshillimi i licencuar dhe nuk është i firmosur nga pronari ose shfrytëzuesi i digës (Bashkia Tropoje) sipas kërkesave të nenit 10 të VKM të mesiperme.

Keshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) dhe SKDM i rekomandoi antarëve të KKDM të mos miratojnë Projekt zbatimin e paraqitur për shkak të mungesave të paraqitura me sipër dhe mosplotësimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

1- Të mos miratojnë Projekt Zbatimin e paraqitur për Rehabilitimin e digës së Tplan në bashkinë Tropoje për shkak të mungesave të konstatuara në dokumentacionin teknik të paraqitur si dhe mosplotësimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2- Ti kërkojë Bashkisë Tropojë si shfrytëzues i digës

- Të plotësojë dokumentacionin teknik të projektit me Studimin dhe Raportin Gjeologjik dhe sizmik, relacionin me karakteristikat e materialeve të ndërtimit, Relacionin dhe llogaritjet përkatëse për verifikimin e qëndrueshmërisë së digës, Relacionin në lidhje me sistemet e monitorimit që duhet të instalohen në digë, Raportin e firmës keshilluese të licencuar dhe me eksperiencë në fushën e digave, relacion në lidhje me rregulloren e shfrytëzimit dhe monitorimit të digës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Te perfshihen ne projekt, sistemet kryesore te monitorimit te diges sipas kerkesave te VKM se mesiperme.
- Të kryeje kontrollin e kapacitetit percjelles të shkarkuesit katastrofik në funksion të rriskut të lartë për zonën urbane poshtë kësaj dige në rast të prishjes së saj apo prurjeve maksimale të ujit sipas kërkesave të Vendimit të KKDM Nr. 36, datë 25.10.2023

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

PER KOMITETIN KOMBËTAR TE DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

